



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/08
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet 4 dhe 5 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/08
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/08
Datë: 13.10.2017


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 49,040.00 (katërdhjet e nëntë mijë e katërdhjetë) euro në kategoritë sipas kërkesës së Komisionit.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nënprogrami Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, nga nën kategoria ekonomike e rezervës me kod 38010 dhe transferohen në Zyrën e Kryeministrit, me kod 104, nën programi Kabineti i Kryeministrit me kod 10700 në kategorinë shpenzimeve Mallra dhe Shërbime në këto kategori ekonomike:
 - shuma prej 29,040 euro ndahen në - shërbimet kontraktuese tjera me kod 13460 dhe
 - shuma prej 10,000 euro ndahen në - akomodimi i udhëtimit zyrtar jashtë vendit me kod 13142;
 - shuma prej 4,000 euro ndahen në - mëditjet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit me kod 13141;
 - shuma prej 2,000 euro ndahen në - shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit me kod 13140.
 - shuma prej 2,000 euro - Dreka zyrtare me kod 14310;
 - shuma prej 1,000 euro - Karburant për vetura me kod 13780;
 - shuma prej 1,000 euro - Furnizim për zyre me kod 13610.
3. Aprovohet kërkesa e Komisionit që sipas nevojës të mund të angazhohen ekspert të fushës, konsulent dhe staf mbështetës.

4. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/08
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 50.000 euro (pesëdhjetëmijë euro), për mbulimin e shpenzimeve për ekspertizë shtesë jashtë vendit lidhur me vdekjen e shtetasit të Republikës së Kosovës z. Astrit Dehari në Qendrën e Paraburgimit në Prizren.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nënprogrami Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, nën kategoria ekonomike e rezervës me kod 38010 dhe transferohen në Këshillin Prokurorial të Kosovës me kod 250, në nënprogramin Prokuroritë dhe Administrata me kod 33500 në kategorinë e shpenzimeve Mallrave dhe Shërbime, në nën kategorinë ekonomike - shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës me kod 13 420.
3. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ
Ramush Haradinaj
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/08

Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Rregullores nr. 26/2012 të Punës së Komisionit Qeveritar për të Drejtat e Ish të burgosurve, të Ish të Dënuarve e të Ish të Përndjekurve Politikë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. I vazhdohet mandati edhe për një (1) vit Komisionit Qeveritar për Njohjen e Statusit të Ish të Dënuarve dhe të ish të Përndjekurve Politikë, në këtë përbërje:
 - 1.1. Rrahim Rama, Ministria e Drejtësisë;
 - 1.2. Basri Ibrahim, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - 1.3. Isak Shabani, Ministria e Shëndetësisë;
 - 1.4. Berat Luzha, Shoqatës e ish të Burgosurve Politikë të Kosovës;
 - 1.5. Mazllum Baraliu, Shoqata e Juristëve të Kosovës;
 - 1.6. Një përfaqësues nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Komisioni nga pika 1. e këtij vendimi që të veprojë në përputhje me Ligjin nr. 03/L-95 për të Drejtat e Ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë, me Rregulloren nr. 26/2012 të Punës së Komisionit Qeveritar për të Drejtat e Ish të burgosurve, të Ish të Dënuarve e të Ish të Përndjekurve Politikë si dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/08
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Me qëllim të thellimit të bashkëpunimit të mëtutjeshëm rajonal dhe mbikëqyrjes së zbatimit të marrëveshjeve ndërshtetërore Z. Fatmir Limaj, Zëvendëskryeministër i Republikës së Kosovës, ngarkohet që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të udhëheqë dhe të koordinojë me politikat ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, dhe koordinimin ndërministror.
2. Zëvendëskryeministri Limaj, ngarkohet për Organizmin e Mbledhjeve të përbashkëta me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe organizimet e mbledhjeve tjera eventuale.
3. Z. Limaj, lidhur me obligimet nga pika 1. e këtij vendimi do të ndihmohet nga Zyra e Kryeministrit dhe ministrisë sipas kërkesave nga ana e tij.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/08
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për dhënën e pajtimit për përjashtimin nga fushëveprimi i nenit 3 paragrafi 3. nënparagrafi 3.4 dhe 3.5 të Ligjit nr. 05/L -068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, në procedurën e blerjes së programeve kompjuterike për nevoja të Sektorit për Hetime të Krimeve Kibernetike" me nr. DPPK-01/0847/2017.
2. Obligohet Policia e Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/08
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Isa Krasniqi, Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, i vazhdohet mandati edhe për 3 (tre) vjet.
2. Z. Krasniqi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/08
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Rrahim Rama, Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, i vazhdohet mandati edhe për 3 (tre) vjet.
2. Z. Rama kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/08
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Ismail Smakiqi, Drejtor i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, i vazhdohet mandati edhe për 3 (tre) vjet.
2. Z. Smakiqi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/08
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës riemërimin edhe për një mandat të z. Krenar Bujupi në pozitën e anëtarit/kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, që vendimin së bashku me biografinë t'ia procedojë për shqyrtim dhe emërim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/08
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit "Konkurrenca e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (Cosme) (2014-2020)".
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që të zhvillojë negociata me Komisionin Evropian, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/08
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për aderim në Organizatën ReSPA.
2. Gjatë procedurës së aderimit, obligohet Ministria e Administratës Publike që të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/08
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 02/L-10 Për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, Udhëzimit Adiminstrativ Nr.2005/10 për luftimin e sëmundjes infektive zoonotike - Tërbimi (Rabies), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 tetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës në territorin e tyre të shpallin gjendjen emergjente dhe të mobilizojnë strukturat e sistemit të mbrojtjes, shpëtimit, ndihmës dhe shërbimeve të tjera emergjente, të cilat do të merren me trajtimin e qenve endacakë për të zvogeluar rrezikun e qytetarëve, ku do të përfshinë, zënien, kastrimin, sterilizimin, vaksinimin, dehelmentizimin, identifikimin dhe lëshimin e tyre.
2. Në mungesë të Buxhetit të Komunave, Qeveria e Republikës së Kosovës sipas kërkesave do të ndajë buxhet për mbështetjen e këtij shërbimi në të gjithë territorin e vendit.
3. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë të gjitha komunave do t'u ofron listën e subjekteve veterinare të licencuara, t'u siguron dhe shpërndan vaksinat kundër sëmundjes së Tërbimit, tabletat për dehelmentizimin e qenve kundër sëmundjeve parazitare, materialin shpenzues (shiringa dhe gjilpëra), për realizimin e vaksinimit.
4. Në bashkëpunim me Autoritetet Komunale, AUV do të siguron monitorimin e kryerjes së shërbimeve në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.
5. Obligohet Ministria e Financave, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Komunat e Republikës së Kosovës, për zbatimin e këtij vendimi në pajtim me Legjislacionin në fuqi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë